



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

RELACION

Korçë, më _____.____.2023

“PËRMIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”

Subvencionimi i qirasë ose bonusi i strehimit është një instrument financiar në funksion të programit të banesave sociale me qira, qëndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesëne qirasësociale ose të qirasë reale ne tregun e lirë.

Bazuar në vlerësimin e nevojave për strehim dhe mundësitë financiare për të mbështetur me fonde këtë program që aplikon Bashkia Korçë”Subvencionimi i qirasë” për familjet e pastreha pa të ardhura ,me të ardhura të ulëta, shumë të ulëta do të kryhet në bashkëfinancim me fonde të siguruara nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave bazuar në kufinj të financimit sipas Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”, ku thuhet që, financimi nga buxheti i shtetit për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore do të bëhet në varësi të të ardhurave për frymë të NJVV.Raporti në bashkëfinancim është i detyruar në kufinj të më pak se 30% e fondit të nevojshëm nga buxheti i bashkisë dhe 70% e fondit tjetër mbështetet nga buxheti i shtetit.Për vitin 2023 ,për programin e subvencionimit të qirasë nga MFE na është miratuar fondi në vlerën 1,160,195 Lek.

Për aplikimet që kanë bërë qytetarët për të përfituar nga programet e strehimit social dhe që plotësojnë kushtet për ”Subvencionimin e qirasë”, për vitin 2023 kemi 1 familje tjetër e cila nuk është në listën e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.10 datë 25.01.2023 “Për miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha” dhe në mbështetje të :

-Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve 16,3, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji,

-VKM 384 , datë 12.06.2019,“Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”,

-VKM 362 , datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”,

-VKM nr.459 datë 3.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”,

-VKM nr.301, datë 15.04.2020 ”Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”,

-Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”,

- Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”,
- Ligjit nr.68/2017 “Për financat evetqeverisjes vendore”,
- VKB Nr 183, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023dhe të PBA 2023-2025 të Bashkisë Bashkisë Korçë” dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë tëautorizojë:
 - Subvencionin e qirasë për 1familje aplikante ,sipas tabelës bashkangjitur.
 - Subvencioni i qirasë do t’i jepet përfituesit qënga data e lidhjes së kontratës.

Drejtoore Strehimit Social
Menaxhimit të Banesave Sociale.
Mirela Balli

Drejtoore e Përgjithshme Juridike dhe
dhe e Burimeve Njerëzore.
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi

Drejtoore e Përgjithshme të Financës ,Buxhetit dhe MFK.
Valbona Ziko

KRYETARE E KOMISIONIT TË STREHIMIT
Benila Themeli

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr., datë .2022

“PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

Bazuar në Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve 3, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB Nr 183, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 dhe të PBA 2023-2025 të Bashkisë Bashkisë Korçë” dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, bazuar dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, Këshilli Bashkiak Korçë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitues nga programi i “Subvencionimit të Qirasë” 1 (një) familje aplikante, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencioni i qirasë do t’u jepet përfituesve që nga data e lidhjes së kontratës.
3. Përzbatimin e këtij vendim i garkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Kryetari Këshillit Bashkiak
Erjon NEXHIPI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2023

“PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasimorinëshqyrtimrelacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, bazuar në dispozitat ligjore, në Ligjin nr.22/2018, “Për Strehimin Social”, të neneve 3, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384”, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, VKB Nr 183, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2023 dhe të PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë” dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Të miratojë përfitues nga programi i “Subvencionimit të Qirasë” 1 (një) familje aplikante, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencioni i qirasë do t’u jepet përfituesve që nga data e lidhjes së kontratës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak **K R Y E T A R**

Eva NAÇI

Erjon NEXHIPI

Miratuar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____

